

KËRKESË

Nr. 4002/1, datë 20.7.2017

PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore, arë, truall, pyll, kullotë”, që preken nga “Ndërtimi i linjës 110 kv, Memaliaj - Gjirokastrë, shtylla lidhëse me nënstacionin”.

Subjekti kërkuar i këtij shpronësimi është: “OST” sh.a. Tiranë.

Me anën e këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e kompensimit përkatës të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë për secilin pronar sipas listës emërore të mëposhtme. Brenda 15 ditëve nga data e fundit e publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË SË ENERGJISË DHE INDUSTRIË

Koli Bele